



UNIVERSITETI SHETËROR I TETOVËS

STATE UNIVERSITY OF TETOVA - ДРЖАВЕН УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО

SUT Rectorate - Ilinden nn, 1200 Tetovo, Macedonia

Tel: +389 44 356 500; Fax: +389 44 334 222, email: international@unite.edu.mk

FLETËPARAQITJE E TEZËS SË MAGJISTRATURËS

- **Emri dhe mbiemri i studentit:**
- **Fakulteti:**
- **Programi studimor:**
- **Drejtimi:**
- **Numri i dosjes:**
- **Viti akademik i regjistrimit të studimeve:**
- **Disiplina shkencore e temës:**

TEMA:

“ _____ ”

Tetovë, ___/___/201_

1. LËNDA E HULUMTIMIT

1.1 ARSYETIMI I TEMËS

(Këtu shkurtimisht përmendet rëndësia e temës, duke e arsyetuar të njëjtën për realizimin e saj, nevojën shkencore për tu realizuar etj.)

1.2 QASJA TEORIKE DHE DEFINIMI I PROBLEMIT TË HULUMTIMIT

(Të përmendet aspekti teorik i lëndës së hulumtimit, hulumtime të ngjashme dhe qartë, saktë të definohet problemi kryesor i këtij hulumtimit)

2. KORNIZA METODOLOGJIKE

2.1 QËLLIMET DHE DETYRAT E HULUMTIMIT

Të parashtrohen qëllimet që hulumtuesi dëshiron të arrijë me këtë punim;

2.2 HIPOTEZAT E HULUMTIMIT

Hipotezat duhet të plotësojnë kriteret e nevojshme për formulim të hipotezave, duhet të jenë logjike, të mundshme për tu testuar, të përmbajnë relacione të qarta mes variablave të hulumtimit etj.

2.3 DEFINIMI I VARIABLAVE

Këtu definohen dhe operacionalizohen saktë variablat kryesore të hulumtimit, subshkallët e tyre, shndërrimi i tyre në njësi matëse etj.

2.4 METODAT SHKENCORE TË HULUMTIMIT

Të përshkruhet dhe arsyetohet metoda shkencore përmes së cilës do të arrihet deri te realizimi i këtij projekti;

2.5 TEKNIKAT OSE INSTRUMENTET MATËSE

Të potencohet, përshkruhet dhe arsyetohet teknika apo instrumenti matës që do të përdoret për matjen e variablave të hulumtimit. Për testet të cilat janë përdorur në ndonjë hulumtim nga dikush tjetër, besueshmëria e arritur, pyetjet që masin variablat, kushtet për tu realizuar matja e saktë etj.

2.6 POPULLACIONI DHE MOSTRA

Të përshkruhen karakteristikat demografike të mostrës, arsyetimi i përzgjedhjes së mostrës, metodat përmes të cilave është përzgjedhur mostra për të marrë pjesë në hulumtim, numri i subjekteve etj.

2.7 METODAT STATISTIKORE PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE

Të përmenden metodat statistikore përmes të cilave do të bëhet përpunimi i të dhënave. Të njëjtat duhet të potencohen se për verifikimin e

cilës hipotezë janë të nevojshme, respektivisht të arsyetohet nevoja e aplikimit të një statistike të caktuar.

2.8 INTERPRETIMI I REZULTATEVE NGA HULUMTIMI

Duhet të theksohet se si do të bëhet interpretimi i rezultateve të arritura e të konstatuara.

2.9 ORGANIZIMI DHE ECURIA E HULUMTIMIT

Në këtë fazë duhet të përmendet saktë i gjithë plani për realizimin empirik të hulumtimit. Duke filluar nga koha e realizimit, vendi, kushtet, aplikimi në mostër, kushtet dhe kriteret e realizimit etj. Të përshkruhet e gjithë ecuria e nevojshme duke u arsyetuar. Mjetet e nevojshme etj.

3. PËRFUNDIMI

Të theksohen arritjet profesionale apo shkencore të cilat priten, zbatimi i rezultateve nga kërkimi etj.

4. BIBLIOGRAFIA

Të pasqyrohet lista e literaturës dhe burimeve tjera.

- Fletëparaqitja e tezës së magistraturës, është një projekt ideor apo propozim temë, në të cilën duhet saktë të theksohet problemi i hulumtimit, të përshkruhen saktë të gjitha fazat në të cilat do të realizohet i gjithë punimi;
- Propozim tema, duhet të jenë një plan konkret i gjithë punës e cila do të realizohet më tutje;
- Projekti ideor, duhet të përmbajë kontiunitet të variablave të zgjedhura për t'u analizuar, prej te titulli i temës duke vazhduar me të gjitha fazat tjera të përcaktuara;
- Të theksohet dhe arsyetohet saktë përdorimi i metodës shkencore të zgjedhur për hulumtimin;
- Të respektohen plotësisht të gjitha kriteret caktuara metodologjike shkencore e të gjitha fazave të projektit, i cili do të realizohet;
- Bibliografia e nevojshme për realizimin e projektit të theksohet në përputhje me standardet e përcaktuara metodologjike, varësisht natyrës së burimit;
 - Propozim teza nuk duhet të jetë më shumë se 15 faqe A4.